



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 252

Tiranë – E mërkurë, 28 dhjetor 2016

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 73, datë 16.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 00-2013-729 (361), datë 6.5.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2014-3742, datë 11.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	25413
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 74, datë 16.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 1058, datë 13.8.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 38, datë 21.1.2002, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 665, datë 17.6.2002, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	25418
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 75, datë 16.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 438, datë 10.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.....	25422
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 76, datë 16.12.2016	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2304 (282), datë 10.4.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).....	25428



VENDIM
Nr. 73, datë 16.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 8.11.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 65 Akti, që i përket:

KËRKUES: Mehmet Biçaku

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Rajonale AKU Elbasan Drejtoria e Përgjithshme AKU Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 00-2013-729 (361), datë 6.5.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2014-3742, datë 11.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 43, 131/f, 133 dhe 134/1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, dokumentacionin e paraqitur nga subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale AKU Elbasan, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesi ka kryer detyrën e specialistit në sektorin e Laboratorit Ushqimor në Drejtorinë Rajonale të Autoriteti Kombëtar të Ushqimit (AKU) të qarkut Elbasan deri në datën 1.9.2010, datë në të cilën i është komunikuar verbalisht

përfundimi i marrëdhënieve të punës, pasi nuk rezultonte në listën e fituesve në procesin e rekrutimit të punonjësve të AKU-së.

2. Në këto kushte kërkesi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadi me objekt detyrimin e subjekteve të interesuara ta rikthejnë në punën e mëparshme si specialist laboratorit në Drejtorinë Rajonale të AKU-së të qarkut Elbasan dhe t'i paguajnë pagën nga ndërprerja e marrëdhënieve të punës deri në rimarrjen në punë.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 1258 (13-2011-2693), datë 1.6.2011, ka vendosur pranimin e padisë, kthimin e kërkesit në punën e mëparshme dhe detyrimin e subjektit të interesuar AKU-së Tiranë t'i paguajë atij pagën nga data 1.9.2010 deri në datën e rimarrjes në punë.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 10-2013-729 (361), datë 6.5.2013, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1258 (13-2011-2693), datë 1.6.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke rrëzuar kërkesëpadinë e kërkesit.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-3742, datë 11.12.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

II

6. **Kërkesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (në vijim “Gjykata”) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë me pretendimin se:

6.1 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka respektuar ligjin material, pasi nuk janë vlerësuar pretendimet e ngritura në rekurs.

6.2 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shkelur ligjin procedural, pasi nuk i ka dhënë mundësi kërkesit për t'u dëgjuar mbi shkaqet e paraqitura në rekurs. Gjithashtu, Kolegji Administrativ nuk ka vlerësuar procedurat e konkurrimit për vendin e punës.

6.3 Kolegji Administrativ edhe pse në prani të dy vendimeve me vlerësime të ndryshme, nuk i ka dhënë mundësinë kërkesit të paraqesë argumentet e tij ligjore për pretendimet e ngritura në rekurs.



6.4 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk është shprehur lidhur me kërkimin për dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës.

6.5 Kolegji Administrativ ka mbajtur qëndrime të kundërta për të njëjtin objekt gjykimi.

7. **Subjekti i interesuar, Drejtoria Rajonale AKU Elbasan**, ka prapësuar me shkrim se ajo nuk disponon dokumentacion në lidhje me emërimin apo shkarkimin nga puna të punonjësve.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

8. Kërkuarisi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

9. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuarisi, *prima facie* legjitimohet edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tij hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës së aksesit

10. Kërkuarisi pretendon se Kolegji Administrativ edhe pse në prani të dy vendimeve me vlerësime të ndryshme, nuk i ka dhënë mundësinë kërkuarisi të paraqesë argumentet e tij ligjore për pretendimet e ngritura në rekurs.

11. Çështjen e pranisë së dy vendimeve diametralisht të kundërta Gjykata në jurisprudencën e saj e ka vlerësuar nën dritën e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe të së drejtës së ankimit në kuptimin substancial (*shih vendimin nr. 24, datë 25. 4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element

thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënë, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar gjithashtu se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për gjykimin në Gjykatën e Lartë, sipas Kodit të Procedurës Civile (nenet 472 e në vijim), rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore mbi të cilat mbështeten, dhe shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Gjykata në këtë drejtim ka theksuar se është kompetencë e Kolegjit Civil/Penal (dhoma e këshillimit) të analizojë dhe vlerësojë nëse shkaqet e ngritura në rekurs janë në përputhje me



kërkesat e ligjit. Megjithatë, ky standard nuk duhet kuptuar sikur i mundëson Gjykatës së Lartë ushtrimin e kompetencës së mësipërme në mënyrë diskrecionale. Gjykata ka theksuar se standardet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor duhen respektuar në të gjitha fazat e gjykimit, përfshirë këtu shqyrtimin e rekursit nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi. Rekursi është i vetmi mjet procedural në dispozicion të kërkuarit, me anë të të cilit ai mund të ketë akses në Gjykatën e Lartë, duke e investuar këtë të fundit me shqyrtimin e pretendimeve të tij (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në çështjen në shqyrtim Gjykata vëren se dy gjykata të niveleve të ndryshme, ajo e shkallës së parë dhe ajo e apelit, i kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta zgjidhjes së mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan ka arsyetuar se “*largimi i tij nga puna është bërë në kundërshtim me nenin 144 të Kodit të Punës [...] dhe se pala e paditur e ka zgjidhur kontratën në kundërshtim me nenin 153 të Kodit të Punës, pasi paditësi nuk ka shkëlur asnjë detyrim kontraktual*”. Ajo ka arritur në përfundimin se pretendimi i kërkuarit është i bazuar dhe ka vendosur kthimin e kërkuarit në punën e mëparshme dhe detyrimin e subjektit të interesuar, AKU-së Tiranë, t’i paguajë atij pagën për periudhën 1.9.2010 deri në datën e rimarrjes në punë. Ndërsa, Gjykata e Apelit Durrës e ka rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuarit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se rekursi i paraqitur nga kërkuari nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimit e mosmarrëveshjeve administrative”, duke arsyetuar se ai mund të kërkonte në gjykatë dëmshpërblimin për zgjidhjen e marrëdhënies së punës dhe jo rikthimin në detyrë (*shih faqen 3 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

17. Gjykata vëren se kërkesëpadia e kërkuarit për rikthimin në punë të tij bazohet në nenet 143 e vijues të Kodit të Punës. Ky i fundit në nenet 146/3 dhe 153/3 parashikon se në rastet e zgjidhjes së menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës nga punëdhënësi, gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat, vendos detyrimin e punëdhënësit ndaj punëmarrësit me një

dëmshpërblim jo më shumë se paga e një viti pune. Sipas vendimeve unifikuese nr. 31, datë 14.4.2003 dhe nr.7, datë 1.6.2011, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë: “*drejta e dëmshpërblimit është një e drejtë që gëzon mbrojtje. Pala që dëmtohet nga një pushim i pa drejtë nga puna gëzon të drejtën e dëmshpërblimit në rrugë gjyqësore. [...] Nuk është e nevojshme të kërkohet në mënyrë të shprehur dëmshpërblimi. [...] mjafton të kundërshtohet akti me të cilin është zgjidhur kontrata dhe gjykata duhet të marrë në shqyrtim edhe pasojat që vijnë nga zgjidhja e paligjshme e kontratës, d.m.th. dëmshpërblimin*”.

18. Në rastin në shqyrtim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke ju referuar vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, edhe pse pranon se kërkuari mund të kërkojë në gjykatë dëmshpërblimin, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës, vendos mospranimin e rekursit, pavarësisht se dëmshpërblimi i është njohur kërkuarit nga gjykata e shkallës së parë dhe mohuar nga ajo e apelit. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se një arsyetim i tillë i Gjykatës së Lartë e bën vendimin e saj kontradiktor dhe alogjik.

19. Duke arsyetuar më tej, edhe pse interpretimi i ligjit material e procedural dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, Gjykata ka vlerësuar se në një shtet të së drejtës roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i pazëvendësueshëm. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat që të marrë një rol aktiv, i cili shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se Gjykata e Lartë, rast pas rasti, duhet t’u japë përgjigje problemeve ligjore që në praktikë lidhen me interpretimin e ligjit. Sipas Gjykatës në të tilla raste kërkuarit, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese, për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet jo vetëm e drejta e aksesit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, por edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 24, datë 25.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t’i drejtohen një gjykate, e cila



do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë, për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'u drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individit) të drejtën për t'u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj. Pra, me Kushtetutë, kujtdo i garantohet e drejta për t'u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkallim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtë Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile/penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimin nr. 6, datë 10.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Bazuar në sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë nëpërmjet një vendimi kontradiktor dhe alogjik në arsyetim, që bie ndesh me përfundimin e arritur në dispozitiv për mospranimin e rekursit, i ka mohuar kërkuesit gjithashtu të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial.

C. Për pretendimet e tjera

24. Për sa u takon pretendimeve të tjera të kërkuesit, që kanë të bëjnë me cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe me faktin se Gjykata e Lartë nuk është shprehur lidhur me kërkimin për dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës, Gjykata vlerëson të mos ndalet në analizimin e tyre, për sa kohë çështja do të merret përsëri në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, e cila në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit dhe si kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta duhet t'u japë pretendimeve të ngritura në rekurs përgjigje të arsyetuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuashëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-3742, datë 11.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Altina Xhoxhaj

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkues Mehmet Biçaku jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin pjesërisht të kërkesës, shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-3742, datë 11.12.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë.

2. Sipas kërkuesit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka shkelur ligjin procedural, pasi nuk i ka dhënë atij mundësinë për t'u dëgjuar mbi shkaqet e paraqitura në rekurs, si dhe të



paraqesë argumentet e tij ligjore për pretendimet e ngritura në rekurs. Po ashtu, kërkuesi ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk është shprehur lidhur me kërkimin për dëmshpërblimin për zgjidhjen e kontratës.

3. Shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuetit duhet të vlerësohen nën dritën e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të së drejtës së aksesit në gjykatë, si dhe të së drejtës së ankimit në kuptimin substancial (*shih paragrafin 11 të vendimit*). Më tej, sipas saj: *“Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke ju referuar vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara, edhe pse pranon se kërkuesi mund të kërkojë në gjykatë dëmshpërblimin, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punës, vendos mospranimin e rekursit, pavarësisht se dëmshpërblimi i është njohur kërkuetit nga gjykata e shkallës së parë dhe mohuar nga ajo e apelit. Nisur nga sa më lart, Gjykata vlerëson se një arsyetim i tillë i Gjykatës së Lartë e bën vendimin e saj kontradiktor dhe alogjik. Bazuar në sa më lart, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë nëpërmjet një vendimi kontradiktor dhe alogjik në arsyetim, që bie ndesh me përfundimin e arritur në dispozitiv për mospranimin e rekursit, i ka mohuar kërkuetit gjithashtu të drejtën e aksesit në gjykatë, si dhe të drejtën e ankimit në kuptimin substancial.”* (*shih paragrafët 18 dhe 23 të vendimit*).

4. Gjykata ka theksuar se detyrimi për të provuar ekzistencën e shkeljeve të së drejtës për proces të rregullt nga shqyrtimi i rekursit në dhomën e këshillimit bie mbi kërkuetin dhe nëse ai nuk arrin ta provojë këtë, atëherë nuk mund të konkludohet se vendimi i dhomës së këshillimit është rezultat i një procesi të parregullt ligjor (*shih vendimin nr. 19, datë 19.7.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, Gjykata ka theksuar se kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 22, datë 6.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo sepse, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport midis juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave

individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (*shih vendimin nr. 52, datë 2.12.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në kuptim të sa më sipër, jurisprudenca e Gjykatës ka ecur në linjën që një vendim gjyqësor i dhomës së këshillimit cenon të drejtën për një proces të rregullt në ato raste kur në procesin e zhvilluar në shkallët më të ulëta të gjykimit është konstatuar cenimi i kësaj të drejte kushtetuese të individit në një nga elementet përbërëse të saj, e cila është e vetmja e drejtë kushtetuese procedurale që i lejon individit të mbrojë të drejtat e tjera të tij substanciale. Në rast të evidentimit të një cenimi të tillë, të konstatuar në shkallët e tjera të gjykimit, Gjykata, në zbatim të parimit të subsidiaritetit, e ka kthyer çështjen në Gjykatën e Lartë në mënyrë që vetë ajo gjykatë, në funksion të pozicionit të saj në piramidën gjyqësore, të mund të riparojë shkeljet e kryera brenda sistemit gjyqësor. Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe në atë të kontrollit të respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbajë qëndrim të shprehur lidhur me pretendimet e ngritura nga individët për cenimin e një prej standardeve të procesit të rregullt të evidentuar në gjykimin e faktit.

6. Por, në rastet kur Gjykata nuk konstaton cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në procesin gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit, ajo nuk mund të vërë në dyshim procesin e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, duke u mbështetur thjesht në faktin se është vendosur mospranimi i rekursit në dhomë këshillimi. Ky proces është vënë në dyshim nga Gjykata vetëm në rastin kur këto vendime nuk përmbajnë shkaqet e ngritura në rekurs, çka sipas Gjykatës cenon parimin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Megjithatë, edhe në lidhje me këtë parim Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson zbatimin e tij rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme këtë detyrim (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Zbatimi dhe interpretimi i normës ligjore është së pari dhe mbi të gjitha funksioni kryesor i gjykatës. Sistemi gjyqësor njeh disa shkallë gjykimi, me qëllim që shkeljet e kryera nga një gjykatë, procedurale apo materiale, të riparohen në një gjykatë më të lartë. Gjykata e Lartë, si gjykatë e



ligjit, ka kompetencën të vlerësojë dhe sigurojë zbatimin uniform të ligjit. Por kjo nuk nënkupton që në të gjitha rastet kur dy gjykatat e faktit kanë bërë një interpretim të ndryshëm të ligjit, Gjykata e Lartë ka detyrimin që të shprehet lidhur me mënyrën se si ai ligj i zbatueshëm duhet të interpretohet. Vlerësimi që Gjykata e Lartë i bën rekursit në dhomën e këshillimit nuk është një vlerësim formal, por është një vlerësim i të gjitha shkaqeve të ngritura në rekurs dhe bazueshmërisë së tyre duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në përfundim të këtij vlerësimi, nëse Kolegji i Gjykatës së Lartë arrin në përfundimin se interpretimi që ka bërë Gjykata e Apelit, i cili është ai që kundërshtohet në rekurs, është i drejtë, është në kompetencën e tij të vendosë mospranimin e rekursit.

8. Bazuar në standardet e mësipërme vlerësoj se në rastin konkret përderisa Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit, kjo do të thotë se të gjitha shkaqet e ngritura në të nga kërkuesi, për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk gjejnë mbështetje as në ligj, as në materialet e çështjes. Kolegji Administrativ ka realizuar një proces vlerësimi të shkaqeve të paraqitura në rekurs nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

9. Për të gjitha argumentet e mësipërme vlerësoj se kërkesa duhej të rrëzohej si haptazi e pabazuar.

Anëtare: Altina Xhoxhaj

VENDIM

Nr. 74, datë 16.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 10.11.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 63 Akti, që i përket:

Faqe | 25418

KËRKUES: Rakip Koni, Petrit Koni

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Arif Kuçi, Abdyl Elezi

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 1058, datë 13.8.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 38, datë 21.1.2002, të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 665, datë 17.6.2002, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33/1, 41, 42, 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27–31 dhe 45, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuesit, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Arif Kuçi, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Subjekti i interesuar Arif Kuçi, me aktin nr. 7, datë 18.11.1993, ka marrë në pronësi, ndër të tjera, edhe parcelën nr. 219, me sipërfaqe 4.000 m² në fshatin Bilalas. Nga kjo parcelë 3.000 m² i janë dhënë kërkuesit Rakip Koni me aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. 86, datë 9.8.1994, ndërsa pjesa tjetër prej 1000 m² i është dhënë kërkuesit Petrit Koni dhe subjektit të interesuar Abdyl Elezi.

2. Subjekti i interesuar Arif Kuçi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi me objekt dorëzimin e parcelës me sipërfaqe 4.000 m², detyrimin për shpërblim dëmi për përdorimin e sendit dhe deklarimin të pavlefshëm të aktit të marrjes në pronësi të parcelës prej 3.000 m² në emër të kërkuesit Rakip Koni. Kërkuesit Rakip Koni dhe Petrit Koni si dhe subjekti i interesuar Abdyl Elezi kanë paraqitur kundërpadi me objekt detyrimin e subjektit të interesuar Arif Kuçi të njohë pronarë të paditurit për sipërfaqen prej 4.000 m² dhe fshirjen nga regjistri hipotekor të kësaj pasurie në emër të Arif Kuçit.



3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 1058, datë 13.8.2001, ka vendosur pranimin e padisë, detyrimin e kërkuesit Petrit Koni dhe të subjektit të interesuar Abdyl Elezi t'i lirojnë dhe dorëzojnë subjektit të interesuar Arif Kuçi sipërfaqen prej 1.000 m², detyrimin e kërkuesit Rakip Koni t'i lirojë dhe dorëzojë subjektit të interesuar Arif Kuçi sipërfaqen prej 3.000 m², detyrimin e të paditurve të dëmshpërblejnë paditësin, deklarimin të pavlefshëm të aktit të marrjes në pronësi të sipërfaqes prej 3.000 m² në emër të kërkuesit Rakip Koni.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 38, datë 21.1.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 1058, datë 13.8.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 665, datë 17.6.2002, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi Rakip Koni.

6. Ndaj subjektit të interesuar Arif Kuçi ka filluar procedim penal për kryerjen e veprës penale falsifikim i dokumenteve. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 576, datë 5.11.2009, ka vendosur deklarimin fajtor të Arif Kuçit për falsifikim të formularëve, konkretisht aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 7, datë 18.11.1993. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 84 (10-2010-241), datë 18.3.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 576, datë 5.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe pushimin e çështjes ndaj subjektit të interesuar Arif Kuçi. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 51, datë 9.3.2011, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 84 (10-2010-241), datë 18.3.2010, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 576, datë 5.11.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

7. Bazuar në këto vendime penale, kërkuesit Rakip Koni dhe Petrit Koni i janë drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikim të vendimeve civile të dhëna në të tria shkallët si më sipër, kërkesë e cila është rrëzuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015.

II

8. **Kërkuesit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tyre është zhvilluar një proces i parregullt ligjor

gjatë rishikimit në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ata kanë parashtruar se:

8.1 Gjykata e Lartë ka dalë tej kompetencave që i njeh ligji në rastet e rishikimit, duke bërë vlerësim të provave dhe shqyrtim në themel të çështjes. Ajo gjithashtu nuk ka marrë parasysh faktet e vërtetuara me një vendim penal të formës së prerë, sipas të cilave akti i marrjes së tokës në pronësi nga Arif Kuçi është i falsifikuar.

8.2 Gjykata e Lartë në kundërshtim me nenet 472, 494, 495, 496, 497 dhe 498 të KPC-së, i ka hyrë vlerësimit të vendimit penal si provë, nuk e ka mbështetur atë në provat e paraqitura gjatë gjykimeve, si dhe pranon fakte të ndryshme nga ato të cilat janë vërtetuar gjatë gjykimeve.

9. **Subjekti i interesuar, Arif Kuçi**, ka prapësuar me shkrim në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:

9.1 Gjykata e Lartë nuk e ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, sepse ka zbatuar me përpikëri kompetencat e përcaktuara në nenet 494 dhe 498 të KPC-së.

9.2 Gjykata e Lartë nëse do të pranonte kërkesën për rishikim do të cenonte parimin e sigurisë juridike, pasi prona posedohet prej rreth 20 vjetësh prej tij.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

10. Kërkuesit legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tyre, të cilat i kanë paraqitur në kërkesë në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës.

11. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, Gjykata çmon se lidhur me shfuqizimin e vendimeve nr. 1058, datë 13.8.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. 38, datë 21.1.2002, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe nr. 665, datë 17.6.2002, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë kërkuesit nuk legjitimohen për t'iu drejtuar Gjykatës me këtë kërkim, pasi nisur nga data e vendimeve kërkesa është paraqitur tej afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar në nenin 30/2, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Në këto kushte ata legjitimohen *ratione temporis* vetëm për vendimin nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.



12. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkuesit për vendimin e rishikimit të Gjykatës së Lartë, *prima facie* legjitimohen edhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e tyre hyjnë në juridiksionin kushtetues. Këto pretendime janë shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj

13. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë ka dalë tej kompetencave që i njeh ligji në rastet e rishikimit, duke bërë vlerësim të provave dhe shqyrtim në themel të çështjes. Ajo gjithashtu nuk ka marrë parasysh faktet e vërtetuara me një vendim penal të formës së prerë, sipas të cilave akti i marrjes së tokës në pronësi nga Arif Kuçi është i falsifikuar. Për pasojë, Gjykata e Lartë ishte e detyruar të prishte vendimet gjyqësore civile të cilat Arif Kuçi i kishte fituar nëpërmjet këtij dokumenti të falsifikuar. Sipas kërkuesve, Gjykata e Lartë i ka hyrë vlerësimit të vendimit penal si provë, nuk e ka mbështetur atë në provat e paraqitura gjatë gjykimeve të mëparshme, si dhe ka pranuar fakte të ndryshme nga ato të cilat janë vërtetuar gjatë gjykimeve.

14. Gjykata vlerëson se të dyja pretendimet e kërkuesve kanë të bëjnë me parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Ky parim është konsideruar në jurisprudencën e Gjykatës si një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky parim karakterizohet, në sensin material, nga funksioni gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjrisht të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Nga ana tjetër, Gjykata, për sa i përket rishikimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, është shprehur se vlerësimi që bën Kolegji i Gjykatës së Lartë në këto raste është i ndryshëm

nga ai që bën kur vihet në lëvizje nëpërmjet rekursit. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Për këto arsye, rishikimi i vendimit, si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë, është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj (*shih vendimin nr. 49, datë 10.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Gjykata është shprehur se gjyqtari që shqyrton kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë nuk kryen vlerësime të reja, në themel, të të njëjtave fakte të vlerësuara nga gjykata në gjykimin e themelit, por kryen një vlerësim, për herë të parë, të fakteve/provave të reja, të cilat nuk kanë qenë më parë objekt gjykimi, diskutimi dhe vlerësimi nga gjykatat që kanë dhënë vendimin për të cilin bëhet rishikimi. Rishikimi i vendimit si një mjet ankimor kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë është i kufizuar vetëm në shkaqet e rishikimit të përcaktuara me ligj, që në asnjë mënyrë nuk përfshijnë veprimtarinë vlerësuese të gjyqtarit në gjykimin që kërkohet/pranohet të rishikohet (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në rastin në shqyrtim Gjykata vëren se kërkuesit kanë paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikim dhe e kanë bazuar atë në nenin 494/ç të KPC-së, sipas të cilit pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi civil që ka marrë formë të prerë, kur vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara. Për këtë arsye, ata kanë depozituar vendimin penal të formës së prerë (nr. 576/2009), që ka deklaruar fajtor subjektin e interesuar Arif Kuçi për falsifikimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi (nr. 7/1993). Gjithashtu, Gjykata vëren se ky dokument rezulton të jetë administruar si provë kryesore në



vendimin civil të formës së prerë që është kërkuar të rishikohet nga Gjykata e Lartë.

18. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015, në seancë gjyqësore, ka rrëzuar kërkesën për rishikim, duke u shprehur se “*kërkesa e paraqitur nga kërkuessit nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 494 të KPC-së. Në interpretim dhe zbatim të nenit 494 të KPC-së, shkaku i paraqitur për rishikim nuk motivon vënien në dyshim, çmuarjen dhe vlerësimin e fakteve nga gjykatat më të ulëta mbi njohjen e të drejtës së pronësisë me vendim gjyqësor të formës së prerë Arif Kuçit, me qëllim hapjen e rrugës për një gjykim të ri të çështjes nga e para. Ky Kolegj duke vlerësuar në mënyrë tërësore dhe objektive interesat e palëve në proces çmon se shkaku për rishikim i pretenduar nga kërkuessit Rakip Koni, etj. nuk është i tillë që të përligjë cenimin e parimit të sigurisë juridike si një nga parimet bazë të shtetit të së drejtës, që synon të garantojë shtetasit se një marrëdhënie juridike e përcaktuar nga një vendim i formës së prerë, është e pandryshueshme” (shih paragrafët 10, 14 dhe 15 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

19. Gjykata vëren se sipas Gjykatës së Lartë “*rrethanat e konstatuara nga procesi penal dhe të pretenduara nga kërkuessi Rakip Koni, etj. si shkak rishikimi, nuk janë thelbësore për të përligjur domosdoshmërinë e cenimit të së drejtës së pronësisë njohur paditësit/ të kundërpaditur Arif Kuçi me një vendim gjyqësor të formës së prerë që prej vitit 2001. Kolegji Civil çmon se mungesa formale e nënshkrimit origjinal të Arif Kuçit, konstatuar nga procesi penal, tek akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 7, datë 18.11.1993, në zërin “Kryefamiljar”, nuk ndikon në ligjshmërinë e vetë aktit të pronësisë vlerësuar në tërësinë e tij në procesin civil të përfunduar. Ky Kolegj, duke e vlerësuar mungesën e nënshkrimit në zërin marrësi “Kryefamiljar”, përkundrejt elementeve të tjerë të aktit administrativ, si: i) nxjerrja e aktit nga një organ i identifikuar; ii) brenda kompetencave të tij; iii) nënshkruar nga personat përgjegjës, të cilët rezultojnë të provuar gjatë hetimit nga gjykatat e faktit në procesin civil, çmon se një mungesë e tillë formale, nuk justifikon shmangien nga parimi i mos cenimit të sigurisë juridike” (shih paragrafët 20–22 të vendimit të Gjykatës së Lartë).*

20. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vlerësuar: “*e drejta e pronësisë dhënë Arif Kuçit me anë të aktit të marrjes së tokës në pronësi nr. 7, datë 18.11.1993, nga vetë organet shtetërore nuk është kundërshtuar apo hequr në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji, por janë pikërisht këto organe shtetërore (KQNT) që pas nxjerrjes*

së AMTP-së kanë marrë vendimin nr.30, të vitit 1996 për kalimin e sipërfaqes objekt gjykimi fsbatit Maminas. Kështu, organet shtetërore me veprimet dhe mosveprimet e tyre në jo vetëm krijimin, por dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjes midis palëve ndërgjyqëse, duke trajtuar të njëjtën sipërfaqe për dy subjekte të ndryshme, si dhe mos pajisja me pronë tjetër e Arif Kuçit, përbën shkelje nga këto të fundit të detyrimit të tyre për të garantuar dhe mbrojtur të drejtën e pronësisë” (shih paragrafët 24–25 të vendimit të Gjykatës së Lartë).

21. Bazuar në standardet e jurisprudencës kushtetuese dhe nisur nga arsyetimi i mësipërm i Gjykatës së Lartë, Gjykata çmon se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë e ka vlerësuar shkaku e rishikimit në raport me e parimin sigurisë juridike dhe në lidhje me të drejtën e pronës. Ai nuk ka arsyetuar se neni 494/ç i KPC-së duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me nenin 495 të KPC-së, sipas të cilit rishikimi i vendimeve për rrethanat e parashikuara në shkronjat “b”, “c” dhe “ç”, të nenit 494 të KPC-së lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim penal të formës së prerë. Pavarësisht kësaj situatë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka arritur në përfundimin se shkaku i rishikimit nuk përligj cenimin e parimit të sigurisë juridike dhe të së drejtës së pronësisë të njohur me vendim të formës së prerë. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë, edhe pse në prani të një vendim penal të formës së prerë që ka vërtetuar se akti i marrjes së tokës në pronësi nr. 7, datë 18.11.1993 në favor të Arif Kuçit përmban të dhëna të rreme, siç janë ato që kanë të bëjnë me përpilimin dhe nënshkrimin nga një person jokompetent dhe i paautorizuar, si dhe nënshkrimin e falsifikuar të marrësit të tokës në pronësi (të gjykuarit), nuk e ka lejuar rishikimin.

22. Nga ana tjetër, Kolegji i Gjykatës së Lartë, duke vendosur rrëzimin e kërkesës, ka kapërcyer kompetencat e tij të parashikuara nga neni 498 i KPC-së, sipas të cilit Gjykata e Lartë ose vendos mospranimin e kërkesës kur ajo është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494, kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, ose vendos prishjen e vendimit dhe e dërgon çështjen për rigjykim nga një tjetër trup gjykues në gjykatën kompetente.

23. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë



ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, si element i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, ky pretendim i kërkuesve është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri¹,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtuëshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2015-829 (21), datë 22.1.2015, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 75, datë 16.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

¹ Gjyqtarja A. Xhoxhaj është shprehur pro vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, por me qëndrimin se arsyetimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë u ka cenuar kërkuesve të drejtën e aksesit në gjykatë.

me sekretare Edmira Babaj, në datën 1.11.2016, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 62 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Lavdije Kasa

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Bajram Shehu, Safet Kasa, Resmije Kasa, Donika Kasa, Blerim Kasa, Elsa Kasa, Elisabeta Kasa, Indrit Kasa

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtuëshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 438, datë 10.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 2, 25, 27 dhe 30, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses e të subjekteve të interesuara, Safet Kasa e Resmije Kasa, që kërkuan pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesja ka qenë palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt: “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitblerjes nr. 6430/1223, datë 27.9.1999”. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kontrata e shitjes së 9800 m² tokë bujqësore trull kundrejt çmimit 1000000 lekë është lidhur midis Safet Kasës (babai i kërkueses) dhe Donika Kasës (motra e kërkueses), me cilësinë e shitësit, dhe B.Sh., me cilësinë e blerësit. Kërkuesja, me pretendimin se në kohën kur është nënshkruar kontrata e shitblerjes ajo ka qenë pjesëtare e familjes bujqësore dhe nuk ka shprehur vullnetin për tjetërsimin e pjesës së saj të pronësisë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, e cila, me vendimin nr. 555, datë 7.4.2004, ka vendosur pranimin e padisë, duke i kthyer palët në gjendjen e mëparshme.

2. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 41, datë 10.2.2005, ka vendosur prishjen e



vendimit të mësipërm dhe dërgimin e çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, pas rigjyimit të çështjes, me vendimin nr. 1146, datë 28.6.2005, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditëses Lavdije Kasa ndaj të paditurve B.Sh., S.K., R.K., D.K., B.K., E.K., E.K. e I.K. me objekt “Konstatimin e pavlefshëm të kontratës së shitblerjes nr. 6430/1223, datë 27.9.1999”.

4. Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.285, datë 5.6.2006, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 1146, datë 28.6.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”.

5. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 113, datë 19.2.2008, ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 285, datë 5.6.2006, të Gjykatës së Apelit Durrës”.

6. Kërkuesja, duke pretenduar falsifikimin e certifikatës së gjendjes familjare të datës 1.8.1991, ka paraqitur në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan një kallëzim penal, në lidhje me të cilin prokuroria, me vendimin nr. 686, datë 28.10.2010, ka vendosur pushimin e hetimeve, pasi “*vepra penale e përdorimit të akteve të gjendjes civile të falsifikuara, parashikuar nga neni 191, paragrafi i parë i Kodit Penal, është parashkruar*”.

7. Në vitin 2011 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore të mësipërme. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2123, datë 10.7.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim.

8. Po ashtu, kërkuesja i është drejtuar edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan me kërkesëpadi me objekt: “*Goditjen për falsitet të certifikatave të përdorura në zyrën noteriale për hartimin e kontratës së shitblerjes...*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 493, datë 10.5.2012, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe konstatimin si të pavërtetë të certifikatës së përbërjes familjare nr. 22/30, datë 1.8.1991, lëshuar në emër të kryefamiljarit Safet Kasa nga zyra e gjendjes civile Belsh për shkak të mospasqyrimit të emrit të Lavdije Kasës (Kurti).

II

9. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 16.6.2016 për shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë,

që ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

9.1 Provat e reja të paraqitura në Gjykatën e Lartë janë akte të lëshuara nga organe kompetente, si Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Edhe pse vendimet e prokurorisë, të gjykatës, si dhe shkresat përkatëse kanë qenë të depozituara në Gjykatën e Lartë kur u vendos rrëzimi i kërkesës për rishikimin e vendimit, ato nuk përmenden të plota në vendimin gjyqësor. Konkretisht, me shkresën nr. L-62, datë 27.6.2012 është dërguar në Gjykatën e Lartë kopja e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka konstatuar si të pavërtetë përmbajtjen e certifikatës së përbërjes familjare nr. 22/30, datë 1.8.1991, për shkak të mospasqyrimin në të të emrit të Lavdije Kasës.

9.2 Përfitimi i tokës sipas ligjit nr. 7501, datë 17.7.1991, “Për tokën”, vërteton se kërkuesja ka qenë anëtare e familjes bujqësore dhe e regjistruar në fshatin Seferan kur është ndarë toka. Edhe sipas vërtetimit të zyrës së gjendjes civile të Bashkisë Belsh, të datës 6.1.2010, provohet se gjendja civile e kërkueses është transferuar në Karbunarë të Lushnjës pas martesës.

10. **Subjekti i interesuar Resmë Kasa** (nëna e kërkueses) ka parashtruar me shkrim se edhe pse i ka nënshkruar disa dokumente, ajo nuk ka pasur dijeni për përmbajtjen e tyre. Sipas saj, kërkuesja ka të drejtë të kërkojë rishikimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, pasi ajo e ka përfituar tokën në bazë të ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, si dhe të VKM-së nr. 255, datë 2.8.1991, ku përcaktohej se toka ndahej për frymë për të gjithë ata që nga data 1.8.1991 figuronin të regjistruar në gjendjen civile të asaj ish-kooperative ku banonin dhe ku ndahej toka.

11. **Subjekti i interesuar Safet Kasa** (babai i kërkueses) në mënyrë të përmbledhur argumenton se:

11.1 Gjatë hetimeve të prokurorisë dhe shqyrtimit të çështjes nga gjykata u vërtetua bindshëm se certifikata e gjendjes së përbërjes familjare nr. 22/30 e datës 1.8.1991, e përdorur në kontratën noteriale të shitblerjes së tokës nr. 6430 prot., nr. 1223 kol., datë 27.9.1999, ka qenë



e falsifikuar, fakt i cili pranohet nga vetë nëpunësja e gjendjes civile, megjithatë nuk u pranua asnjëherë si provë në gjykim.

11.2 Shitja e tokës bujqësore kundrejt çmimit prej 1000000 lekësh është bërë bazuar në dokumentacionin e përgatitur nga Bajram Shehu, pas marrëveshjes verbale me të dhe pa pasur dijeni paraprakisht për falsifikimin e certifikatës të përbërjes familjare.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

12. Gjykata vlerëson se kërkuësja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të rregullimit kushtetues të neneve 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës, dhe *ratione temporis*, pasi pretendimet e saj janë paraqitur brenda afatit ligjor dyvjeçar të parashikuar nga neni 30/2 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata rithekson se bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individit për shkeljen e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi ai të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e kësaj të drejte. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkeljen e së drejtës themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuësi shteron mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor, çka nënkupton se kërkuësi duhet t'i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të së drejtës të pretenduar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr.1, datë 25.1.2010; nr. 17, datë 16.5.2011; nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata ka vlerësuar se në rastet kur kundërshtohet procesi i rishikimit i zhvilluar në Gjykatën e Lartë, për vetë specifikën e këtij lloji gjykimi, duke qenë se rishikimi është mjet i jashtëzakonshëm dhe vendimi i Gjykatës së Lartë është përfundimtar, kërkuësi nuk ka mjet tjetër për të goditur vendimin që ka pranuar kërkesën

për rishikim dhe ka vendosur prishjen e vendimeve gjyqësore të formës së prerë (*shih vendimet nr. 17, datë 18.7.2005; nr. 5, datë 26.1.2007; nr. 6, datë 16.2.2007; nr. 38, datë 5.7.2012; nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim kërkuësja legjitimohet për vënien në lëvizje të juridiksionit kushtetues, në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës për akses në Gjykatën e Lartë

16. Kërkuësja ka pretenduar se ndonëse në datën 27.6.2012 ka depozituar në Gjykatën e Lartë kopjen e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka konstatuar si të pavërtetë përmbajtjen e certifikatës së përbërjes familjare nr. 22/30, datë 1.8.1991, Kolegji Civil nuk e ka analizuar këtë provë të re dhe ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikimin e vendimeve gjyqësore që kanë pasur për objekt konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së shitblerjes.

17. Gjykata bazuar në parimin *jura novit curia*, ka theksuar se ajo mund të vlerësojë vetë nëse pretendimet e ngritura në kërkesë bien në fushën e veprimit të një dispozite të caktuar që nuk është parashtruar para saj dhe se ajo nuk e konsideron veten të detyruar nga cilësimi që u është bërë fakteve të çështjes nga kërkuësi (*shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, pavarësisht nga fakti se kërkuësja nuk ka evidentuar konkretisht standardin e cenuar, Gjykata vlerëson se pretendimi i saj se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi) ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim pa u bazuar në të gjitha provat e depozituara, duhet të trajtohet në këndvështrim të respektimit të standardit të arsyetimit të vendimit dhe të së drejtës së aksesit në gjykatë.

18. Kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim



ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimin nr. 36, datë 26.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Duke marrë parasysh natyrën e shqyrtimit të çështjes në rastet e rishikimit, ajo ka të bëjë jo vetëm me konstatimin e fakteve, por edhe me vlerësimin e tyre nga Gjykata e Lartë (*shih vendimin nr. 18, datë 23.4.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me arsyetimin e vendimeve gjyqësore, në jurisprudencën kushtetuese mbizotëron qëndrimi se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 25, datë 10.6.2011; nr. 8, datë 28.2.2012; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 3, datë 23.1.2014, të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 23, datë 4.11.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 8, datë 16.3.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e

provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 38, datë 30.12.2010; nr. 20, datë 13.4.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referenca në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se detyrimi për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Bazuar në parashikimet e normave procedurale që përcaktojnë elementet që duhet të përmbajë një vendim gjyqësor, si dhe në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore



përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*sbib vendimet nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 36, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Nga rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkesja, nëpërmjet mbrojtësit të saj, në datën 17.1.2011 ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimeve gjyqësore. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 11.5.2012 ka vendosur kalimin për shqyrtim në seancë plenare të kërkesës, me arsyetimin se përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 494 i Kodit të Procedurës Civile. Nga aktet e dosjes gjyqësore të tërhequr për të verifikuar pretendimin e kërkuarës rezulton se në të gjendet e depozituar shkresa nr. L-62 e datës 27.6.2012, me anë të së cilës mbrojtësi i kërkuarës ka depozituar në Gjykatën e Lartë vendimin nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka vendosur: *“Konstatimin si të pavërtetë të certifikatës së përbërjes familjare me nr. 22/30, datë 1.8.1991 lëshuar në emër të k/familjarit Safet Kasa nga zyra e gjendjes civile Belsh për shkak të mospasqyrimin të emrit të kërkuarës”*.

24. Gjykata, referuar pjesës hyrëse të vendimit objekt kundërshtimi, konstaton se si prova të reja renditen *“vendimi datë 28.10.2010, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan, shkresa prot. 942, datë 23.12.2010 e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimi nr. 1146, datë 28.6.2005 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nr. 258, datë 6.5.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës, nr. 113, datë 19.2.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë”*. Në pjesën arsyetuese Kolegji Civil shprehet se *“...kërkesja duhet të paraqesë si provë të re një vendim gjyqësor penal të formës së prerë që vërteton falsitetin e dokumentit dhe kur kjo nuk është e mundur për shkak se çështja penale nuk mund të fillojë ose përfundojë për një nga shkaqet e treguara në nenin 290 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të paraqesë një vendim civil, i cili vërteton falsitetin e dokumentit... kërkesja ka paraqitur si provë të re vetëm vendimin e pushimit të prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan”*.

25. Në vështrim të fakteve të mësipërme dhe duke pasur parasysh qëllimin dhe natyrën e këtij mjeti të veçantë ankimi, Gjykata vlerëson se mospasqyrimi dhe mosanalizimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i vendimit nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, që ka vendosur konstatimin si të pavërtetë të certifikatës së përbërjes familjare nr.

22/30, datë 1.8.1991, i cili ka qenë i administruar në dosje në kohën e shqyrtimit të çështjes, e bën vendimmarrjen objekt kundërshtimi të vesuar në drejtim të mosrespektimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit, si dhe ngre dyshime serioze edhe për cenimin e aksesit efektiv në atë gjykim. Gjykata vlerëson se mospranimi i kërkesës për rishikim si rrjedhojë e zhvillimit të një procesi gjyqësor në cenim të garancive të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i ka hequr përfundimisht kërkuarës mundësinë për rivendosjen e së drejtës së cenuar, që në thelbin e vet ka pasur për objekt të drejtën e pronësisë.

26. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, është i bazuar dhe duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”*, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtuashëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2123 (438), datë 10.7.2014 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha

Anëtarë kundër: Fatos Lulo

MENDIM PAKICE

1. Në çështjen me kërkuarës Lavdije Kasën, unë gjyqtari në pakicë jam kundër qëndrimit të shumicës për pranimin e kërkesës, shfuqizimin si



të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2014-2123 (438), datë 10.7.2014, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

2. Kërkuësja ka pretenduar para Gjykatës së Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim pa u bazuar në të gjitha provat e depozituara.

3. Sipas shumicës, vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është i vesuar në drejtim të mosrespektimit të standardit të arsytimit të vendimit, si dhe ngre dyshime serioze edhe për cenimin e aksesit efektiv në gjykatë. Këtë përfundim shumica e mbështet tek fakti i mospasqyrimin dhe mosanalizimit nga Kolegji Civil të vendimit nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, duke pranuar pretendimin e kërkuësese se ky vendim ka qenë i administruar në dosje në kohën e shqyrtimit të çështjes (§ 25 i vendimit).

4. Gjykata ka theksuar se kërkesa për rishikim përfaqëson një formë të veçantë ankimi, një mjet të jashtëzakonshëm, me anë të të cilit kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Nëpërmjet këtij mjeti ankimi mund të hapet një gjykim i mbyllur në mënyrë përfundimtare nga gjykata. Kërkesa për rishikim ushtrohet për shkaqe që qëndrojnë jashtë procesit të themelit, që do të thotë për fakte, prova, rrethana ose ngjarje për të cilat pala nuk kishte dijeni, nuk kishin ndodhur ose nuk ishin vërtetuar gjatë procesit gjyqësor dhe që kanë ndikuar në dhënien e vendimit në fjalë. Duke qenë një mjet i jashtëzakonshëm, pasi ka për objekt një vendim gjyqësor të formës së prerë, me autoritetin e gjësë së gjykuar, pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor vetëm për një numër të kufizuar shkaqesh, të parashikuara shprehimisht nga dispozitat procedurale përkatëse (*shih vendimin nr. 17, datë 24.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2123, datë 10.7.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim të kërkuësese.

6. Ashtu sikundër edhe shumica eidenton, Kolegji Civil në arsytimin e vendimit të tij, si prova të reja të administruara në proces, rendit “vendimin datë 28.10.2010 të Prokurorisë së

Rrethit Gjyqësor Elbasan, shkresën prot. 942, datë 23.12.2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimin nr. 1146, datë 28.6.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, vendimin nr. 258, datë 6.5.2006 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe vendimin nr. 113, datë 19.2.2008, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (§ 24 i vendimit). Ndërkohë, vendimi gjyqësor për të cilin pretendon kërkuësja nuk figuron në këto prova.

7. Duke u mbështetur në këtë arsytim të Kolegjit Civil, si edhe duke shqyrtuar materialet e dosjes gjyqësore vërehet se në momentin e dorëzimit të kërkesës për rishikim kërkuësja ka depozituar vetëm provat e sipërcituara, ndërsa vendimi nr. 493, datë 10.5.2012, vihet në dyshim përderisa nuk figuron ndër këto prova.

8. Në ndryshim nga sa arsyeton shumica, jam i mendimit se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka respektuar kufijtë e shqyrtimit të çështjes që i njihen atij, duke analizuar dhe vlerësuar provat e administruara në gjykim në këndvështrim të respektimit të dispozitave ligjore të zbatueshme për zgjidhjen e çështjes konkrete në shqyrtim. Pasi ka marrë në shqyrtim provat e administruara në dosjen gjyqësore, të cilat janë të pasqyruara edhe në procesverbalin e administrimit të provave, Kolegji Civil ka arritur në përfundimin se kërkesa nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 494 të KPC-së. Gjithashtu, Kolegji Civil ka respektuar edhe standardet e arsytimit të vendimit gjyqësor të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

9. Në ndryshim nga shumica, jam i mendimit se Kolegji Civil me të drejtë nuk e ka marrë në shqyrtim dhe nuk e ka analizuar vendimin nr. 493, datë 10.5.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Ky vendim gjendej në dosjen gjyqësore edhe pse nuk ishte dorëzuar nga kërkuësja në momentin e paraqitjes së kërkesës për rishikim, por nuk figuronte në procesverbalin e administrimit të provave që mban Gjykata e Lartë. Mospasqyrimi i këtij vendimi në procesverbalin e administrimit të provave hedh dyshime mbi vendosjen e këtij të fundit në dosje. Provat të cilat gjenden në dosjen gjyqësore duhet të korrespondojnë me procesverbalin e administrimit të provave. Gjykata nuk mund të marrë në shqyrtim prova të tjera përveç atyre që



gjenden në dosjen gjyqësore dhe që janë të pasqyruara në procesverbal.

10. Në rastin në shqyrtim, bazuar në standardet e mësipërme, si dhe në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, rezulton se vlerësimi i kësaj gjykate, sipas kompetencave të saj, është përqendruar vetëm në provat e depozituara dhe të administruara në gjykatë sipas rregullave procedurale.

11. Për sa më sipër, vlerësoj se pretendimi i kërkuësës se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës për rishikim pa u bazuar në të gjitha provat e depozituara është i pabazuar, për rrjedhojë Gjykata duhej të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Anëtar: Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 76, datë 16.12.2016

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha,	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 21.7.2016, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 46 Akti, që u përket palëve:

KËRKUESE: shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-2304 (282), datë 10.4.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

BAZA LIGJORE: Nenet 41, 42, 131/f dhe 134/1/g, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr.8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Faqe | 25428

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fatmir Hoxha, shqyrtoi pretendimet e kërkuësës, që kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga materialet bashkëlidhur kërkesës rezulton se kërkuësja, shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit ka lidhur me subjektin e interesuar, Bashkinë Tiranë, dy kontrata sipërmarrje për sistemimin dhe asfaltimin e rrugës “Vasil Shanto” – ura “Irfan Tomini”. Sipas kontratave periudha e garancisë së punimeve ka qenë 12 muaj duke përcaktuar se 5 % e vlerës do t’i mbahej sipërmarrësit në formën e garancisë. Në përfundim të punimeve kërkuësja ka kërkuar kthimin e shumës së garancisë së punimeve dhe në kushtet kur kjo kërkesë nuk është plotësuar, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duke paditur subjektin e interesuar Bashkinë Tiranë me kërkesëpadi me objekt detyrimin për të përmbushur detyrimet kontraktore sipas kontratave të sipërmarrjes të lidhura në datat 10.5.2000 dhe 30.6.2000, si dhe detyrimin për të paguar kamatëvonesat.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 10238, datë 8.12.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Mbi ankimin e subjektit të interesuar, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1921, datë 21.10.2010, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 10238, datë 8.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e padisë, detyrimin e subjektit të interesuar të paguajë vlerën e garancisë në masën 5 % sipas kontratave përkatëse, si dhe kamatëvonesat duke filluar nga data 31.10.2002 deri në ekzekutimin e vendimit.

4. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë subjekti i interesuar, si dhe kundërrekurs kërkuësja. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2304 (282), datë 10.4.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1921, datë 21.10.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 10238, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.



II

5. **Kërkuesja shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k.**, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2014-2304 (282), datë 10.4.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke parashtruar si vijon:

5.1 Në Gjykatën e Lartë është zhvilluar një proces jo i rregullt ligjor pasi është cenuar e drejta e njoftimit për gjykim. Kërkuesja nuk është njoftuar 21 ditë para shqyrtimit të rekursit, por as në një moment tjetër, sipas nenit 61, të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Gjykimi është zhvilluar në datën 10.4.2014 ndërsa ndryshimet në ligj lidhur me mënyrën e njoftimit janë bërë me ligjin nr. 100, datë 31.7.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49, datë 3.5.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Shoqëria nuk ka marrë dijeni për vendimin e gjykatës.

5.2 Është cenuar parimi i gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj, pasi Kolegji Administrativ e ka shqyrtuar çështjen në themel, duke rivlerësuar provat e marra nga gjykatat e zakonshme e duke vendosur në kundërshtim me to.

5.3 Është cenuar parimi i pritshmërive të ligjshme dhe barazisë në të drejta, pasi Kolegji e ka konsideruar kushtin penal si garanci për deformimet dhe veset e veprës, në kundërshtim edhe me jurisprudencën e saj.

5.4 Është cenuar parimi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë duhet të arsyetonte si ka arritur në përfundimin se garancia për deformimet dhe veset e veprës është kusht penal vlerësues.

5.5 Është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Sipas nenit 60, të ligjit nr. 49/2012, Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve. Rezulton se dosja është dërguar për gjykim në datën 22.12.2010 dhe vendimi është marrë në datën 10.4.2014.

6. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, nuk ka paraqitur prapësime me shkrim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses

7. Gjykata vlerëson se kërkuesja, shoqëria “Karl Gega Konstruksion” sh.p.k., legjitimohet *ratione personae* pasi parashikohet si subjekt nga neni 134+/1/g i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit 2-vjeçar të parashikuar nga neni 30, pika 2, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Gjithashtu kërkuesja legjitimohet *ratione materiae*, pasi pretendimet e saj hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata në vijim do të shqyrtojë pretendimin për cenimin e së drejtës së njoftimit dhe parimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për të marrë pjesë në gjykim

8. Kërkuesja ka pretenduar se është cenuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim pasi nuk ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Edhe pse bazuar në nenin 21, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012) njoftimi duhet të bëhej nga sekretaria, kjo e fundit nuk ka marrë masa për të përmbushur detyrimin ligjor.

9. Gjykata, bazuar në materialet e çështjes konkrete, konstaton se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje me rekursin e subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, në datën 19.11.2010 dhe sipas dëftesës së komunikimit kërkuesja ka marrë dijeni për rekursin në datën 30.11.2010 dhe në datën 9.12.2010 ajo ka paraqitur kundërrekurs. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në datën 3.7.2013 ka vendosur kalimin e çështjes për gjykim kurse në datën 10.4.2014 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka nisur shqyrtimin e saj.

10. Gjykata vëren se me miratimin e ligjit nr. 49/2012 është parashikuar, mes të tjerash, edhe procedura e gjykimit të këtyre çështjeve. Sipas nenit 59 të këtij ligji pala kundër së cilës është



bërë rekurs mund të kundërshtojë pretendimet e ngritura në rekurs brenda 15 ditëve nga komunikimi i rekursit dhe mosparaqitja e kundërrekursit brenda këtij afati sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë. Dërgimi i dosjes së gjykimit në Gjykatën e Lartë bëhet brenda 10 ditëve nga data e përfundimit të komunikimeve të rekursit e kundërrekursit palëve ndërgjyqëse në proces, bazuar në nenin 60 të ligjit. Shqyrtimi i rekursit në Gjykatën e Lartë, sipas nenit 61 të ligjit, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Për efekt të gjykimit gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sipas pikës 2, të nenit 61 të ligjit, sekretaria e gjykatës njofton sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë dhe me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara. Po ashtu, ligji ka parashikuar edhe rastet kur çështja shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve bazuar në nenin 62. Ligji nr. 49/2012 është ndryshuar me ligjin nr. 100, datë 31.7.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Me këtë ligj ka ndryshuar edhe neni 61 lidhur me mënyrën e njoftimit të palëve, duke përcaktuar se sekretaria e gjykatës njofton me shpallje ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit.

11. Gjykata konstaton se shqyrtimi i çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është bërë sipas ligjit nr. 49/2012. Bazuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë gjatë seancës së datës 10.4.2014 është tërhequr për të marrë vendim dhe nuk rezulton të ketë verifikuar nëse kërkuesja ka marrë dijeni për zhvillimin e gjykimit, sipas rregullave të përcaktuara në neni 61/2, të ligjit nr. 49/2012, në të cilin është parashikuar: “*Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, sipas rregullave të përcaktuara për gjykimin në shkallë të parë dhe me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara*”. Në përfundim të

shqyrtimit Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr. 1921, datë 21.10.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 10238, datë 8.12.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

12. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar dallimin mes shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, sipas nenit 480 të KPC-së, si fazë paraprake ku vlerësohet plotësimi ose jo i kriterëve për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore, dhe shqyrtimit të çështjeve në seancë gjyqësore mbi bazë dokumentesh sipas ligjit nr. 49/2012. Megjithëse në shqyrtimin e çështjeve administrative Gjykata, përgjithësisht, procedon me shqyrtimin jo në seancë publike me praninë e palëve, por në dhomë këshillimi mbi bazën e dokumenteve të paraqitura, kjo nuk nënkupton se ky lloj gjykimi përjashton detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve në mënyrë që të mbrohen në procesin gjyqësor ku janë palë me anë të paraqitjes së komenteve apo prapësimeve lidhur me pretendimet e palës që ka vënë në lëvizje gjykatën. Qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e gjykatave administrative ka qenë thjeshtimi i procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative, por duke garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme (*shih vendimin nr. 59, datë 16.9.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në këtë kuptim, Gjykata thekson se Gjykata e Lartë ka detyrimin jo vetëm të njoftojë rregullisht palët për procesin, por edhe t’u sigurojë atyre mundësinë që të marrin pjesë në proces dhe të dëgjohen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve. Për këtë qëllim Gjykata e Lartë duhet t’u garantojë palëve të drejtën që jo vetëm të njihen në kohë me pretendimet e palës tjetër, por edhe të kenë mundësinë që t’i kundërshtojnë ato apo të paraqesin argumentet e tyre për çështjen (*shih vendimin nr. 29, datë 19.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata çmon se në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka zbatuar rregullat e njoftimit sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe



funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses se si pasojë e mosnjohimit i është mohuar e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për t’u dëgjuar është i bazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

15. Kërkuësja ka pretenduar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimin të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë. Sipas nenit 60, të ligjit nr. 49/2012, Gjykata e Lartë e shqyrton çështjen brenda 90 ditëve, ndërkohë rezultojnë se dosja është dërguar për gjykim në datën 22.12.2010 ndërsa vendimi është marrë në datën 10.4.2014.

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për pretendimin e cenimit të së drejtës së gjykimin të çështjes brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimin, pasi legjislacioni i brendshëm nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Lidhur me të drejtën e gjykimin brenda një afati të arsyeshëm Gjykata Kushtetuese ka theksuar se arsyeja e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuetit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuetin kjo tejkzgjatje e afateve të gjykimin (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005; nr.1, datë 19.1.2009, të Gjykatës Kushtetuese*). Në çështjen konkrete vlerësimi i elementeve të sipërcituara është me rëndësi për të arritur në përfundimin nëse ndodhemi para cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rrjedhojë e tejkzgjatjes së afatit gjykimin.

i) Periudha e kohës që duhet marrë në konsideratë

18. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë në çështjen në shqyrtim rezultojnë se nga momenti i depozitimit të rekursit nga subjekti i interesuar në datën 19.11.2010 deri në dhënien e vendimit në datën 10.4.2014 ka kaluar një afat prej 4 vjetësh për gjykimin e çështjes nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë. Në nenin 60/2, të ligjit nr. 49/2012 të sipërcituar parashikohet detyrimi për shqyrtimin e çështjes brenda 90 ditëve nga dërgimi i saj prej gjykatës ku është depozituar rekursi.

ii) Kompleksiteti i çështjes

19. Mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës administrative dhe parashikohet e rregullohet sipas ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”. Objekti i saj është vlerësimi i detyrimit kontraktual si rrjedhojë e kontratave të sipërmarrjes të lidhura midis kërkueses dhe subjektit të interesuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit çështja nuk paraqet rrethana komplekse që mund të justifikojnë vonesa në shqyrtimin e saj.

iii) Interesi dhe sjellja e kërkueses

20. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkueses është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës Gjykata çmon se kërkuësja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezultojnë të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim.

iv) Sjellja e autoriteteve

21. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka theksuar në nenin 42 të Kushtetutës e Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 6 të KEDNJ-së parashikohet detyrimi për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave pasqyrohet edhe në dispozitat procedurale civile. Konkretisht, në nenin 4 të KPC-së parashikohet



se gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme. Gjithashtu në nenin 171/a të KPC-së parashikohet: “gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj” (*shih vendimin nr. 12, datë 5.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Lidhur me gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, neni 3 i ligjit nr. 49/2012 ndër parimet e gjykimit administrativ ka përcaktuar sigurimin e një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme. Ky ka qenë edhe qëllimi i ligjvënësimit në krijimin e këtyre gjykatave. Kështu, në relacionin bashkëlidhur projektligjit nr. 49/2012 thuhet se ligji synon thjeshtimin e procedurave me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative dhe se në këtë drejtim qëllimi i krijimit të Gjykatës Administrative është garantimi i mbrojtjes efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshëm të personave nëpërmjet një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se në relacionin e projektligjit të lartpërmendur lexohet se afatet konkrete të përcaktuara në ligj për gjykimin e çështjeve duhet të zbatohen nga gjykatat administrative për shqyrtimin e çështjeve. Për më tepër, në ligjin nr. 49/2012 janë parashikuar afate për gjykimin në shkallë të parë, neni 25 për veprimet përgatitore, neni 27 për caktimin e seancës gjyqësore, neni 48/2 për shqyrtimin e çështjes nga gjykata e apelit, si dhe neni 60/2 për gjykimin në Gjykatën e Lartë.

23. Nga sa më lart, Gjykata ka çmuar se përderisa ligjvënësi ka përcaktuar këto afate kohore (90 ditë në rastin në fjalë), do të thotë se ai i ka konsideruar ato si afate të arsyeshme për t’u zbatuar nga gjykatat administrative. Në këtë drejtim, respektimi rigoroz i ligjit përbën detyrim për Gjykatën e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, për sa kohë ajo ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për këto arsye, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuases për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë brenda afatit të arsyeshëm, të parashikuar nga neni 60/2, i ligjit nr. 49/2012, është i drejtë dhe si i tillë duhet pranuar.

25. Si përfundim, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, për rrjedhojë, kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës².
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2304 (282), datë 10.4.2014, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Sokol Berberi, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj

² Gjyqtare Altina Xhoxhaj ka votuar për pranimin pjesërisht të kërkesës vetëm për pretendimin e cenimit të së drejtës së njoftimit nga Gjykata e Lartë.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 168 lekë